

KARTA E TË
DREJTAVE
FUNDAMENTALE
E BASHKIMIT
EVROPIAN



KARTA E TË DREJTAVE FUNDAMENTALE E BASHKIMIT EVROPIAN

Popujt e Evropës, në
këtë periudhë kur
ndërtohet një union i
bashkuar si kurrë më
parë, janë të vendosur
të ndajnë një të ardhme
pagesore dhe të bazuar
në vlera të përbashkëta.
I vetëdijshëm për

trashëgiminë e vet
shpirtërore dhe morale,
Bashkimi Evropian
themelohet në vlerat
e pandashme dhe
universale të dinjitetit,
lirisë, barazisë dhe
solidaritetit të njeriut;
bazohet në parimet

e demokracisë dhe
ushtrimin e ligjit.
Bashkimi Evropian
vendos individin në
zemër të aktiviteteve
të veta, duke formuar
shtetësinë e Unionit
dhe atë duke krijuar
një zonë të lirisë,

sigurisë dhe drejtësisë.
Bashkimi Evropian
kontribuon në ruajtjen
dhe zhvillimin e këtyre
vlerave të përbashkëta,
duke respektuar
shumëllojshmërinë e
kulturave dhe traditave
të popujve të Evropës,

si dhe respektimin e
identiteteve nacionale
të Shteteve Anëtare
dhe organizimin e
autoriteteve të tyre
në nivel nacional,
rajonal dhe lokal.
Bashkimi Evropian
kërkon të promovojë

zhvillimin e balancuar
dhe të vazhdueshëm
dhe siguron lëvizjen
e lirë të personave,
mallërave, shërbimeve
dhe kapitalit, si dhe
lirinë e institucionit.
Për këtë qëllim, është i
nevojshëm përforcimi i

mbrojtjes të të drejtave
fundamentale me
rastin e ndryshimeve
shoqërore, progresit
social dhe zhvillimeve
shkencore dhe
teknologjike, duke i
bërë këto të drejta më
të dukshme në Kartë.

Me tërë respektin ndaj
fuqive dhe detyrave
të Komunitetit dhe
Bashkimit Evropian
dhe duke marrë
parasysh parimin e
subvencionimit, kjo
Kartë sërish vërteton
të drejtat sipas asaj që

rezultojnë, sidomos nga
traditat kushtetutare
dhe obligimet
ndërkombëtare të
përbashkëta për të
gjitha Shtetet Anëtare,
siç janë Traktati i
Bashkimit Evropian,
Traktatet e Komunitetit,

Konventa Evropiane për
Mbrotjen e të Drejtave
të Njeriut dhe Lirive
Fundamentale, Kartat
Sociale të miratuara
nga Komuniteti dhe nga
Këshilli i Evropës dhe
ligji i përvojës praktike
në Gjykatën e Drejtësisë

të Komuniteteve
Evropiane dhe Gjykatës
Evropiane për të Drejta
të Njeriut. Gëzimi
i këtyre të drejtave
involvon përgjegjësi dhe
detyra që kanë të bëjnë
dhe vlejnë për persona
të tjerë, për komunitetin

njerëzor dhe për
gjeneratat e ardhshme.
Prandaj, Bashkimi
Evropian njih të drejtat,
liritë dhe parimet e
caktuara në vijim.

KAPITULLI I

DINJITETI

Neni 1

Dinjiteti njerëzor

Dinjiteti njerëzor është
i shenjtë. Ai duhet
doemos të respektohet
dhe të mbrohet.

Neni 2

E drejta e jetës

1. Secili ka të drejtë për të jetuar.
2. Askush nuk do të dënohet me vdekje dhe nuk do të ekzekutohet.

Neni 3

E drejta e integritetit të personit

1. Secili ka të drejtën për të gëzuar respektimin e integritetit të vet fizik dhe mendor.

2. Në fushat e medicinës dhe biologjisë, duhen respektuar sidomos pikat në vijim:

a) cpajtimi i lirë dhe i informuar i personit, në pajtim me procedurat e përcaktuara me ligj,

- b) ndalimi i përvojave eugjenike, sidomos ato që synojnë selektimin e personave,
- c) ndalimi i përdorimit të trupit të njeriut dhe pjesëve të trupit

si burim për përfitim
financiar,

d) ndalimi i klonimit
reprodukues të
qenieve njerëzore.

Neni 4

Ndalimi i torturimit
dhe trajtimit
apo dënimit jo të
njerëzishëm ose
degradues

Askush nuk do t'i
nënshtrohet torturës,
trajtimit ose dënimit
jo të njerëzishëm apo
degradues.

Neni 5

Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar

1. Askush nuk duhet të mbahet si skllav apo shërbëtor.

2. Askush nuk duhet të detyrohet të kryejë punë obligative.
3. Trafikimi i qenieve njerëzore është i ndaluar.

KAPITULLI II

LIRITË

Neni 6

E drejta e lirisë dhe sigurisë

**Secili ka të drejtë për
lirinë dhe sigurinë e vet.**

Neni 7

Respektimi i jetës private dhe familjare

**Secili ka të drejtën
të gëzojë respektin
ndaj jetës së tij apo**

të saj private dhe
familjare, shtëpisë dhe
komunikimit.

Neni 8

Mbrojtja e të dhënave personale

- 1. Gjithkush ka të
drejtën e mbrojtjes së
të dhënave personale.**

2. Të dhënat e këtilla
duhet doemos të
përpunohen në
mënyrë të drejtë për
qëllime të caktuara
dhe me pajtimin
e personit në fjalë
ose sipas ndonjë
baze tjetër legjitime

të përcaktuar me
ligj. Gjithkush ka
të drejtë të ketë në
dispozicion të dhënat
e grumbulluara për
atë, si dhe të drejtën e
korrigjimit të këtyre të
dhënave.

3. Pajtimi me këto
rregulla do t'i
nënshtrohet
kontrollit të ndonjë
autoriteti të pavarur.

Neni 9

E drejta e martesës
dhe e drejta për të
krijuar familje

E drejta e martesës dhe
krijimit të familjes do
të garantohet në pajtim

me ligjet nacionale që
qeverisin ushtrimin e
këtyre të drejtave.

Neni 10

E drejta e të menduarit, vetëdijes dhe religjionit

- 1. Secili ka të drejtën
e lirisë së të**

menduarit, vetëdijes
dhe religionit. Kjo e
drejtë përfshin lirinë
e ndryshimit të fesë
ose besimit, si dhe
lirinë e manifestimit
të fesë, qoftë vetëm
ose në bashkësi me të
tjerë, qoftë publikisht

apo privatisht,
gjatë përkushtimit,
mësimit, praktikimit
apo përmbushjes.

2. Njohja e të drejtës së
refuzimit diligjent,
në pajtim me ligjet
nacionale që qeverisin
këtë lloj të drejte.

Neni 11

Liria e të shprehurit dhe informimit

1. Secili ka të drejtën
e lirisë së të
shprehurit. Kjo e
drejtë do të përfshijë

lirinë e mendimeve
dhe pranimi të
informatave dhe
ideve neutral,
pa ndërhyrjen e
autoriteteve publike
dhe pa marrë
parasysh kufijtë.

2. Duhet të respektohet liria dhe pluralizmi i mediave.

Neni 12

Liria e grrumbullimit dhe shoqatave

1. Secili ka të drejtën e lirisë për grrumbullim paqesor dhe lirinë e

krijimit të shoqatave
në të gjitha nivelet,
sidomos për çështje
politike, unione
tregtare dhe çështje
qytetare, gjë që
involvon të drejtën e
secilit, për të formuar
dhe për t'u bashkuar

në unione tregtare
për mbrojtjen e
interesave të tij apo
të saj.

2. Partitë politike
në nivel të
Bashkimit Evropian
kontributojnë për të

shprehur vullnetin
politik të qytetarëve
të Bashkimit
Evropian.

Neni 13

E drejta për arte dhe shkenca

Artet dhe hulumtimet
shkencore nuk do të kenë
kufizime. Liria akademike
duhet të respektohet.

Neni 14

E drejta e arsimimit

1. Secili ka të drejtën e arsimimit dhe për të pasur mundësinë e trajnimit profesional dhe të vazhdueshëm.

2. Kjo e drejtë
përfshin mundësinë
për arsimim të
domosdoshëm pa
pagesë.

3. E drejta për
themelimin e
institucioneve

arsimore me
respektimin e
plotë të parimeve
demokratike dhe e
drejta e prindërve
për t'u siguruar se
arsimimi dhe mësimi
i fëmijëve të tyre në
pajtim me besimet

e tyre religjioze/
fetare, filozofike dhe
pedagogjike duhet të
respektohet në pajtim
me ligjet nacionale që
qeverisin ushtrimin
e kësaj të lirie dhe të
drejte.

Neni 15

Liria për të zgjedhur
profesionin dhe
e drejta për t'u
punësuar

1. Secili ka të drejtë të
angazhohet me punë

dhe të ndjekë një
profesion të zgjedhur
lirshëm ose të
pranuar me dëshirë.

2. Çdo qytetar i
Bashkimit Evropian
gëzon lirinë për të
kërkuar punësim,

për të punuar, për të
ushtruar të drejtën e
krijimit dhe të ofrojë
shërbime në të gjitha
Shtetet Anëtare.

3. Shtetasit e vendeve
në zhvillim, të cilët
janë të autorizuar të

punojnë në territorin
e Shteteve Anëtare
kanë të drejtën e
kushteve të barabarta
të punës me ato
të qytetarëve të
Bashkimit Evropian.

Neni 16

Liria e zhvillimit të biznesit

Duhet të njihet liria për
të zhvilluar një biznes,
në pajtim me ligjin e
Komunitetit dhe ligjet
dhe përvojat nacionale.

Neni 17

E drejta e pronësisë

1. Secili ka të drejtë të posedojë, të përdorë, të organizojë apo të dhurojë atë që posedon dhe që ka fituar në mënyrë të

ligjshme. Askush nuk
duhet të privohet nga
prona e tij apo e saj,
përveç në rastet e
interesit publik dhe
në rastet dhe kushtet
e përcaktuara me ligj,
të cilat i nënshtrohen
kompensimit të

arsyeshëm dhe të
paguar me kohë
për humbjen e tyre.
Përdorimi i pronës
mund të rregullohet me
ligj nëse një gjë e tillë
është e domosdoshme
për interesin e
përgjithshëm.

2. Pronësia intelektuale
do të mbrohet.

Neni 18

E drejta e azilit

E drejta e azilit do
të garantohet duke
respektuar rregullat e
Konventës së Gjenevës
të 28 korrikut 1951
dhe Protokolit të 31

janarit 1967, që kanë
të bëjnë me statusin e
refugjatëve dhe janë në
pajtim me Traktatin që
themelon Komunitetin
Evropian.

Neni 19

Mbrojtja në rast të largimit, përjashtimit ose ekstradimit

1. Ndalohen përjashtimet kolektive.

2. Askush nuk mund
të largohet, të
përfshihet ose të
ekstradohet në ndonjë
Shtet ku ekziston
rreziku i madh që
ai ose ajo mund t'i
nënshtrohen dënimit
me vdekje, torturës

ose llojeve të tjera të
trajtimit apo dënimit
jo të njerëzishëm apo
degradues.

KAPITULLI III

BARAZIA

Neni 20

Barazia para ligjit

Të gjithë janë të
barabartë para ligjit.

Neni 21

Jodiskriminimi

1. Ndalohet çdo lloj diskriminimi që bazohet në gjini, racë, ngjyrë, origjinë etnike apo sociale, karakteristika

gjenetike, gjuhë, fe
apo besim, politikë
ose ndonjë lloj
opinionit tjetër,
anëtarësi të një
pakice nacionale,
pronë, lindje,
paaftësi, moshë ose
orientim seksual.

2. Ndalohet çdo lloj diskriminimi në baza nacionaliteti, në suaza të zbatimit të Traktatit që themelon Komunitetin Evropian dhe Traktatit të Bashkimit Evropian, dhe pa paragjyime

për dispozitat speciale
të këtyre Traktateve.

Neni 22

Shumëllojshmëria kulturore, fetare dhe gjuhësore

Bashkimi Evropian
do të respektojë
shumëllojshmërinë

kulturore, fetare dhe
gjuhësore.

Neni 23

Barazia midis meshkujve dhe femrave

Barazia midis
meshkujve dhe femrave
duhet të garantohet

në të gjitha fushat,
përfshirë këtu edhe
punësimin, punën dhe
pagat.

Parimi i barazisë nuk
do të parandalojë
mirëmbajtjen apo
miratimin e masave

që ofrojnë përparësi
specifike në favor të
gjinive të përfaqësuar
më pak.

Neni 24

Të drejtat e fëmijëve

1. Fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes dhe kujdesit të nevojshëm për mirëqenien e tyre. Ata mund t'i shprehin

qëndrimet e tyre
lirshëm. Qëndrimet
e tilla do të merren
parasysh për çështje
që kanë të bëjnë me
ata, në pajtim me
moshën dhe pjekurinë
e tyre.

2. Në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me fëmijë, qofshin ato të autoriteteve publike apo të institucioneve private, konsideratë primare duhet të jenë interesat e fëmijës.

3. Çdo fëmijë do të
ketë të drejtën
e mirëmbajtjes
së rregullt të
marrëdhënies
personale dhe
kontaktit të
drejtpërdrejtë me të
dy prindët e tij apo

të saj, me përjashtim
të rasteve kur një gjë
e tillë është kundër
interesave të tij apo
të saj.

Neni 25

Të drejtat e të moshuarve

Bashkimi Evropian njih
dhe respekton të drejtat
e më të moshuarve
për të pasur një jetë

dinjitoze dhe të pavarur
dhe për të marrë pjesë
në jetën sociale dhe
kulturore.

Neni 26

Integrimi i personave të paaftë

Bashkimi Evropian
njuh dhe respekton të
drejtat e personave të
paaftë, në mënyrë që

ata të përfitojnë nga
masat e disejnuara për
të garantuar pavarësinë
e tyre, integritetin social
dhe profesional dhe
pjesëmarrjen në jetën e
komunitetit ku jetojnë.

KAPITULLI IV

SOLIDARITETI

Neni 27
Të drejtat e
punëtorëve për
informata dhe
konsultim në suaza
të ndërmarrjes

Punëtorët ose
përfaqësuesit e tyre,
në nivelet përkatëse,
duhet të kenë të
garantuara informata
dhe konsultime me
kohë në rastet dhe në
kushtet e siguruara me
ligjin e Komunitetit, si

dhe ligjet dhe përvijat
nacionale.

Neni 28

E drejta për negociata dhe aksion kolektiv

Punëtorët dhe
punëdhënësit, ose
organizatat e tyre

përkatëse, në pajtim me
ligjin e Komunitetit dhe
ligjet nacionale kanë
të drejtë të negociojnë
dhe të nënshkruajnë
marrëveshje kolektive
në nivele të duhura dhe,
në raste të konflikteve
të interesave, të

ndërmarrin aksione
kolektive për të
mbrojtur interesat e
tyre, përfshirë këtu edhe
aksionet për greva.

Neni 29

E drejta e shërbimeve
të emërimit në vend
pune

Secili ka të drejtën e
qasjes në shërbime të lira
të emërimit në vend pune.

Neni 30

Mbrojtja në raste të shkarkimit të pajustificuar

Çdo punëtor ka të
drejtën e mbrojtjes nga
shkarkimi i pajustificuar,

në pajtim me ligjin e
Komunitetit, si dhe
ligjet dhe përvojat
nacionale.

Neni 31

Kushtet e drejta dhe të arsyeshme të punës

- 1. Çdo punëtor ka të drejtë për kushte të punës që respektojnë**

shëndetin, sigurinë dhe
dinjitetin e tij apo të saj.

2. Çdo punëtor ka të
drejtë për kufizimin
e orarit maksimal të
punës, në periudha të
pushimit ditor dhe javor
dhe në një periudhë

vjetore të pushimit të
paguar.

Neni 32

Ndalimi i punës së fëmijëve dhe mbrojtja e të rinjve në punë

Punësimi i fëmijëve
është i ndaluar. Mosha

minimale e punësimit
nuk guxon të jetë
më e ulët se mosha e
mbarimit të shkollimit,
pa paragjykime për
rregullat e tilla të cilat
mund të jenë më të
favorshme për të rinjtë
dhe me përjashtim

të derogacioneve të
kufizuara. Të rinjtë e
pranuar në punë duhet
të kenë doemos kushte
përkatëse të punës për
moshën e tyre dhe të
jenë të mbrojtur nga
eksploatimi ekonomik
dhe nga çdo lloj pune

tjetër që mund të
dëmtojë sigurinë dhe
shëndetin e tyre ose
zhvillimin e tyre fizik,
mendor, moral ose
social ose të ndërhyjë në
edukimin e tyre.

Neni 33

Jeta familjare dhe profesionale

1. Familja gëzon mbrojtje
ligjore, ekonomike
dhe sociale.

2. Për të balancuar jetën familjare dhe profesionale, secili do të gëzojë të drejtën e mbrojtjes nga shkarkimi, për arsye që kanë të bëjnë me të qenit nënë dhe të drejtën për pushim të

paguar të lindjes dhe
pushimin prindor pas
lindjes ose birësimit
të një fëmije.

Neni 34

Siguria sociale dhe ndihma sociale

1. Bashkimi Evropian
njeh dhe respekton
të drejtën e
beneficioneve të
sigurimit social dhe

shërbimeve sociale
që ofrojnë mbrojtje
në rastet siç janë
materniteti, sëmundja,
aksidentet industriale,
varësia ose mosha e
shtyer, dhe në raste
të humbjes të vendit
të punës, në pajtim

me rregullat e
përcaktuara në ligjin
e Komunitetit dhe
ligjet dhe përvojat
nacionale.

2. Të gjithë personat që
jetojnë dhe lëvizin në
mënyrë të ligjshme
përbrenda Bashkimit

Evropian kanë të drejtë të përfitojnë nga beneficionet e sigurisë sociale dhe përparësive sociale, në pajtim me ligjin e Komunitetit dhe ligjet dhe përvojat nacionale.

3. Për të luftuar
mospërfshirjen
sociale dhe varfërinë,
Bashkimi Evropian
njuh dhe respekton të
drejtën për ndihmë
sociale dhe për
strehim, ashtu që
siguron ekzistencë

të arsyeshme për
të gjithë ata që nuk
kanë resurse të
mjaftueshme, në
pajtim me rregullat e
përcaktuara nga ligji
i Komunitetit si dhe
ligjet dhe përvojat
nacionale.

Neni 35

Kujdesi shëndetësor

Bashkimi Evropian
njuh dhe respekton
përdorimit të lirshëm
të shërbimeve me
interes të përgjithshëm
ekonomik, siç është e

paraparë me ligjet dhe
përvojat nacionale, në
pajtim me Traktatin që
themelon Komunitetin
Evropian, dhe atë për të
promovuar kohezionin
social dhe territorial të
Bashkimit Evropian.

Neni 36

Mbrojtja e ambientit jetësor

Bashkimi Evropian
njeh dhe respekton
përdorim të lirshëm
të shërbimeve me
interes të përgjithshëm

ekonomik, siç është e
paraparë me ligjet dhe
përvojat nacionale, në
pajtim me Traktatin që
themelon Komunitetin
Evropian, dhe atë për të
promovuar kohezionin
social dhe territorial të
Bashkimit Evropian.

Neni 37

Mbrojtja e ambientit jetësor

Një nivel i lartë i
mbrojtjes së ambientit
jetësor dhe përmirësimi
i kualitetit të mjedisit

duhet të integrohen në
politikat e Bashkimit
Evropian dhe të jenë të
garantuara në pajtim
me parimin e.

Neni 38

Mbrojtja e konsumatorëve

Politikat e Bashkimit
Evropian garantojnë
nivel të lartë të mbrojtjes
së konsumatorëve.

KAPITULLI V

TË DRJEJTAT E

QYTETARËVE

Neni 39

**E drejta e votimit
dhe e kandidimit
në zgjedhjet e
Parlamentit
Evropian**

1. Secili qytetar i
Bashkimit Evropian
ka të drejtë të votojë
dhe të kandidohet
në zgjedhjet e
Parlamentit Evropian,
në Shtetin Anëtar
në të cilin ai ose ajo
jeton, me kushtet

e njëjta si ato të
shtetasve të atij Shteti
përkatës.

2. Deputetët e
Parlamentit Evropian
do të zgjidhen në
zgjedhje të lira dhe
sekrete.

Neni 40

E drejta e votimit
dhe e kandidimit në
zgjedhjet komunale

Çdo qytetar i Bashkimit
Evropian ka të drejtë të
votojë dhe të kandidohet

në zgjedhjet komunale
në Shtetin Anëtar në të
cilin ai ose ajo jeton, me
kushtet e njëjta si ato të
shtetasve të atij Shteti.

Neni 41

E drejta për administratë të mirë

1. Çdo person ka të drejtë të zgjedhë çështjet e veta në

mënyrë të drejtë,
dhe përbrenda një
kohe të arsyeshme
nga institucionet dhe
organet e Bashkimit
Evropian.

2. Kjo e drejtë përfshin:

- a) E drejta e çdo personi për t'u shprehur, para se të merren masa individuale që do të ndikonin negativisht;
- b) E drejta e çdo personi të ketë qasje në dosjen

e vet, ndërkohë
duke respektuar
interesat legjitime
të konfidencialitetit
dhe sekreteve
profesionale dhe
afariste;

c) Obligimi i
administratës të japë
arsye për vendimet
e veta.

3. Çdo person ka të
drejtë të kërkojë
nga Komuniteti të
përmirësojë çdo llojë

dëmi të shkaktuar nga
institucionet e veta
ose nëpunësit e vet
gjatë performancës
së detyrave të tyre,
në pajtim me parimet
e përgjithshme, të
përbashkëta për ligjet
e Shteteve Anëtare.

4. Çdo person mund
t'u shkruajë
institucioneve të
Bashkimit Evropian
në njërën nga gjuhët
e Traktateve, dhe
përgjigjet duhet të
jenë në gjuhën e
njëjtë.

Neni 42

E drejta e qasshmërisë në dokumente

**Çdo qytetar i Bashkimit
Ëvropian, dhe çdo
person fizik ose juridik**

që jeton ose që ka
regjistruar zyrë në
ndonjë Shtet Anëtar
ka të drejtë të ketë
qasje në dokumentet e
Parlamentit, Këshillit
dhe Komisionit
Evropian.

Neni 43

Ombudsmani

Çdo qytetar i Bashkimit
Evropian, dhe çdo
person fizik ose
juridik që jeton ose
që ka regjistruar

zyrë në ndonjë Shtet
Anëtar ka të drejtë t'i
referohet Ombudsmanit
të Bashkimit
Evropian në rastet
e keqadministrimit
të aktiviteteve
që i realizojnë
institucionet ose trupat

e Komunitetit, me
përjashtim të Gjykatës të
Drejtësisë dhe Gjykatës
së Instancës së Parë, të
cilat veprojnë në rolin e
tyre gjyqësor.

Neni 44

E drejta e petitionit

Të gjithë qytetarët e
Bashkimit Evropian
dhe secili person fizik
apo juridik që jeton apo
ka regjistruar zyrë në

ndonjërin nga Shtetet
Anëtare ka të drejtë
t'i drejtojë petition
Parlamentit Evropian.

Neni 45

E drejta e lëvizjes dhe rezidencës

1. Çdo qytetar i
Bashkimit Evropian
ka të drejtë të lëvizë
dhe të qëndrojë

lirshëm në territorin e
Shteteve Anëtare.

2. Në pajtim me
Traktatin që themelon
Komunitetin Evropian,
liria e lëvizjes dhe
rezidencës mund t'u
jepet shtetasve të

vendeve në zhvillim,
të cilët qëndrojnë
në mënyrë legale në
territorin e ndonjë
Shteti Anëtar.

Neni 46

Mbrojtja

diplomatike dhe

konsulare

Secili qytetar i
Bashkimit Evropian që
ndodhet në territorin e

një shteti në zhvillim,
ku Shteti Anëtar,
shtetas i të cilit është ai,
nuk është i përfaqësuar,
do të ketë të drejtën
e mbrojtjes nga
autoritetet dipolomatike
dhe konsulare të të
gjitha Shteteve Anëtare,

me kushtet e njëjta si
ato të shtetasve të atij
Shteti Anëtar.

KAPITULLI VI

DREJTËSIA

Neni 47

E drejta për një
zgjidhje efektive
dhe gjykim të drejtë

Të gjithë ata, të cilëve u
janë shkelur të drejtat
dhe liritë e garantuara

me të drejtën e
Bashkimit Evropian,
kanë të drejtën e
zgjidhjes efektive në një
tribunal, në pajtim me
kushtet e caktuara në
këtë Nen.

Të gjithë kanë të drejtën

e seancës dëgjimore
të drejtë dhe publike,
dhe përbrenda një
kohe të arsyeshme, nga
një tribunal i pavarur
dhe neutral i cili
paraprakisht ka qënë i
themeluar në mënyrë të
ligjshme. Të gjithë do të

kenë mundësinë për t'u
këshilluar, për mbrojtje
dhe përfaqësim.

Ndihma juridike do
të jetë në dispozicion
për ata që nuk kanë
resurse të mjaftueshme,
në rastet kur ndihma

e këtillë është e
domosdoshme për
të garantuar qasjen
efektive në drejtësi.

Neni 48

Supozimi i pafajësisë dhe e drejta e mbrojtjes

1. Secili që është
akuzuar do të
konsiderohet i

pafajshëm derisa të
vërtetohet fajësia e tij
sipas ligjit.

2. Garantohet
respektimi i të drejtës
për mbrojtje të secilit
që është akuzuar.

Neni 49
Parimet e
ligjshmërisë dhe
proporcionalitetit
të veprave penale
dhe kundërvajtjeve

1. Askush nuk do të
quhet i fajshëm për
vepra penale për
ndonjë vepër ose
gabim i cili nuk është
konsideruar si vepër
penale në suaza të
ligjit nacional apo
ligjit ndërkombëtar

në kohën kur është
bërë kjo vepër. Dhe
as nuk do të jepet
dënim më i rëndë
se sa dënimi që ka
qënë i zbatueshëm në
kohën kur është kryer
vepra penale. Nëse, si
rrjedhojë e direktivës

së veprës penale, ligji mundëson dënim më të lehtë, ky ligj do të jetë i zbatueshëm.

2. Ky nen nuk do të paragjykojë gjykimin dhe dënimin e çdo njeriu për ndonjë

akt ose gabim, i cili,
në kohën kur është
kryer, ka qënë vepër
penale sipas parimeve
të përgjithshme
të njohura nga
komuniteti i popujve.

3. Rreptësia e dënimeve
nuk guxon të jetë në
disproporcion me
veprën penale.

Neni 50
E drejta e
mosgjykitimit ose
mosdënimit të
dyfishtë për veprën
e njëjtë penale

Asnjë njeri nuk gjykohet
dhe nuk dënohet dy herë
për të njëjtën kundërvajtje
ose vepër penale, për të
cilën ai ose ajo një herë
janë shpallur të pafajshëm
ose janë dënuar përbrenda
Bashkimit Evropian, në
pajtim me ligjin.

KAPITULLI VII
DISPOZITAT E
PËRGJITHSHME

Neni 51

Fushëveprimi

1. Dispozitat e kësaj
Karte vlejnë për
institucionet dhe
trupat e Bashkimit
Evropian, duke
respektuar parimin

e subvencionimit
dhe respektimin e
Shteteve Anëtare,
vetëm kur ato
implementojnë të
drejtën e Bashkimit
Evropian. Prandaj,
këto dispozita duhet
të respektojnë të

drejtat, të respektojnë
parimet dhe kështu të
promovojnë aplikimin
e ligjeve, në pajtim
me fuqitë e tyre
përkatëse.

2. Kjo Kartë nuk
themelon asnjë fuqi

ose detyrë të re për
Komunitetin ose
Bashkimin Evropian,
dhe as nuk modifikon
fugitë dhe detyrat
e definuara në
Traktate.

Neni 52

Fushëveprimi i të drejtave të garantuara

1. Çdo lloj kufizimi
i ushtrimit të të
drejtave dhe lirive

të njohura me këtë
Kartë duhet doemos
të parashihet me ligj
dhe të respektojë
esencën e këtyre të
drejtave dhe lirive.
Varësisht nga parimi
i proporcionalitetit,
kufizimet mund të

bëhen vetëm nëse
vërtetë i plotësojnë
synimet e interesave
të përgjithshme të
njohura nga Bashkimi
Evropian ose nevoja
për të mbrojtur të
drejtat dhe liritë e të
tjerëve.

2. Të drejtat e njohura sipas kësaj Karte, të cilat bazohen në Traktatet e Komunitetit ose në Traktatin e Komunitetit Evropian do të ushtrohen me kushtet dhe

përbrenda kufijve
të definuar nga këto
Traktate.

3. Përderisa kjo Kartë
përmban të drejtat që
korrespondojnë me të
drejtat e garantuara
në Konventën

për Mbrojtjen
e të Drejtave të
Njeriut dhe Lirive
Fundamentale,
kuptimi dhe
fushëveprimi i këtyre
të drejtave do të
jenë të njëjtat si ato
që janë përcaktuar

nga Konventa e
përmendur. Kjo
dispozitë nuk do të
parandalojë të drejtën
e Bashkimit Evropian
që të sigurojë mbrojtje
më të përgjithshme.

Neni 53

Niveli i mbrojtjes

Asgjë në këtë Kartë nuk do të interpretohet si liri fundamentale dhe të drejta të kufizuara ose të dëmshme të njeriut siç janë njohur në fushat

përkatëse të aplikimit,
nga e drejta e Bashkimit
Evropian dhe e drejta
ndërkombëtare, si dhe
nga marrëveshjet në
të cilat marrin pjesë
Bashkimi Evropian,
Komuniteti ose të
gjitha Shtetet Anëtare,

përfshirë këtu edhe
Konventën Evropiane
për Mbrojtjen e të
Drejtave të Njeriut dhe
Liritë Fundamentale, si
dhe nga kushtetutat e
Shteteve Anëtare.

Neni 54

Ndalimi i abuzimit të të drejtave

Asgjë në këtë Kartë
nuk do të interpretohet
si implikim i të gjitha
të drejtave për t'u

angazhuar në çdo
lloj aktiviteti ose
performance që ka për
qëllim shkatërrimin e
të drejtave dhe lirive të
njohura me këtë Kartë
ose kufizimin e këtyre
të drejtave dhe lirive në
shkallë më të lartë se

sa ajo që është paraparë
këtu.

Strasbourg, 12 dhjetor
2007.

MK-32-11-903-SQ-C

ISBN 978-92-9238-034-2

DOI 10.2871/34180

ISBN 978-92-9238-034-2

